



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 20.2.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË ZYRËS SË PRESIDENTIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit të Kosovës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (Udhëheqës Ekipi) dhe Refiqe Morina (Anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	19
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	20
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	23
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Zyrës së Presidentit të Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 29/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i ZPK-së.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Menaxhmentit të ZPK-së - auditimi 2016**

Menaxhmenti i ZPK-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Zyrës së Presidentit të Kosovës (ZPK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i ZPK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Presidentit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ZPK-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin i parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat financiare nëntëmujore;
- Raportet për Obligimet e papaguara;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZPK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga ZPK siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Krahasuar me vitin e kaluar, menaxhmenti i ZPK-së ka bërë përmirësime të theksuara në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Kjo për faktin se, ZPK ka arritur të hartoj regjistrin e rreziqeve kundrejt objektivave të organizatës ku janë përfshirë edhe veprimet e nevojshme për menaxhimin e tyre. Më tutje, progres i theksuar ishte bërë edhe në plotësimin e pyetësorit të vet-vlerësimit. Përgjigjet e dhëna korrespondojnë me gjendjen faktike dhe dokumentet mbështetëse konfirmojnë saktësinë e tyre. Për më tepër, menaxhmenti kishte vendosur mekanizma adekuat për tu informuar me kohë lidhur me proceset dhe sfidat të cilat e kanë përcjellë punën gjatë vitit.

Megjithatë, procesi i zbatimit të rekomandimeve ka ende hapësirë për përmirësim. Kjo pasi që gjysma e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa tjetër ishin në proces.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të ZPK-së ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime kryesore. Pas pranimit të rekomandimeve tona në raportin e auditimit të vitit 2015, ZPK-ja kishte përgatitur një plan veprimi ku ishin caktuar afatet kohore, veprimet që do të ndërmerren dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, nga gjithsej gjashtë (6) rekomandimet e dhëna në raportin e vitit paraprak, tri (3) rekomandime janë zbatuar plotësisht, dy (2) ishin në proces të zbatimit, ndërsa një (1) nuk është zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura	ZPK ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve, megjithatë mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve ka ndikuar që disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ishte e evidente kryesisht te prokurimi dhe të menaxhimi i pasurisë.
Rreziku	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.
Rekomandimi 1	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve.

2.2 Pyetësoni i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të ZPK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi. Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij, dhe kemi vërejtur se ZPK:

- ka hartuar planin vjetor dhe strategjik të saj si dhe ka përcaktuar strategji të përgjithshme të objektivave, gjithashtu janë qartësuar përgjegjësitë për koordinim dhe zhvillim të planit strategjik; dhe
- ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, duke e hartuar planin detaje për trajtimin e rreziqeve të organizatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZPK-ja operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Proceset e Menaxhimit të rrezikut

Menaxhimi i rrezikut si proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve, si dhe zbatimit të kontroleve të nevojshme për të mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut në nivel të pranueshëm është integruar si pjesë e procesit të përgjithshëm të menaxhimit.

Sipas udhëzimeve të përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullës 01/2010, të gjitha organizatat buxhetore duhet të hartojnë një regjistër të menaxhimit të rreziqeve i cili duhet t'i paraprijë procesit të identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të tyre me qëllim zvogëlimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm për të mbështetur një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik.

ZPK-ja pas pranimit të rekomandimit në raportin e auditimit për vitin 2015, kishte arritur të hartojë regjistrin e rreziqeve në të cilin kishte bërë identifikimin e rreziqeve, mënyrën e menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti ka vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe ishte i informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të ZPK-së. Raportimi i rregullt tek menaxhmenti, mundëson një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një auditor i cili njëherësh është Drejtor i njësisë. NjAB-i në përputhje me planin strategjik kishte përgatitur planin vjetor për vitin 2016, i cili përfshinte katër (4) auditime. Të gjitha auditimet e planifikuara ishin realizuar gjatë vitit 2016, duke i ofruar menaxhmentit informata të mjaftueshme në lidhje me funksionimin e sistemit financiar dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme, si dhe ka ofruar rekomandime për përmirësimin e tyre.

Po ashtu edhe Komiteti i Auditimit ishte efektiv duke mbajtur takime të rregullta gjatë vitit. Në ato takime ishin diskutuar çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2015 si dhe çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Edhe në vitin 2016 sikurse në vitin paraprak, ZPK kishte arritur të realizoj pothuajse tërë buxhetin e saj. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore. Në kontekst të sistemeve financiare, shpenzimet lidhur me pagat dhe mëditjet dhe subvencionet ishin menaxhuar në pajtueshmëri me legjislacionin. Megjithatë, kontrollet mbi aktivitetet e prokurimit dhe procedimin e pagesave kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Këto janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,631,433	2,084,059	2,006,996	1,615,564	1,563,370
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,631,433	2,035,591	1,999,796	1,615,564	1,563,370
Donacionet e jashtme	-	48,468	7,200	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për afro 28% apo 452,626€. Kjo rritje ishte bërë pas rishikimit buxhetor, donacioneve të jashtme dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë. Në vitin 2016, ZPK-ja ka përdorur 96.3% të buxhetit final ose 2,006,996€, me një përmirësim të lehtë prej 1.3% krahasuar me vitin e kaluar. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,631,433	2,084,059	2,006,996	1,615,564	1,563,370
Pagat dhe Mëditjet	772,312	868,411	832,676	722,484	624,910
Mallrat dhe Shërbimet	770,421	1,138,571	1,097,303	821,693	876,599
Shërbimet komunale	18,700	8,092	8,033	10,197	10,487
Subvencionet dhe Transferet	70,000	68,985	68,985	42,418	51,374
Investimet kapitale	0	0	0	18,772	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 96,099€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimit të Qeverisë Nr. 07/112 , ku me ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punë është rritur numri i stafit politik dhe mbështetës në kabinetin e Presidentit. Po ashtu është shtuar edhe pensioni për ish Presidenten pas përfundimit të mandatit. Realizimi i buxhetit ishte në masën 99% të buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 368,150€. Rritja ishte rezultat i rishikimit buxhetor, vendimeve të qeverisë, si dhe granteve të përcaktuara të donatorëve. Realizimi i buxhetit ishte në masën 96% të buxhetit final. Krahasuar me vitin 2015 shpenzimet janë rritur për 275,610€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me rritjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit për shkak të aktiviteteve të shtuara të Presidentit, shpenzimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse si dhe shpenzimeve me rastin e inaugurimit të Presidentit;
- Buxheti për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 10,608€ si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit ishte në masën 99% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,015€ sipas vendimit të qeverisë për kursime buxhetore. Kjo kategori e shpenzimeve ishte realizuar në tërësi.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë nga ZPK-ja kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionin e aplikueshëm. Numri i aprovuar i të punësuarve në ZPK ishte 91, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2016 ishte 66 punonjës.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Kontrollat kanë funksionuar mirë në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitet) në vitin 2016 ishte 1,146,663€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,105,336€, ose mbi 94%. ZPK-ja ka forcuar kontrollat në raport me vitin paraprak, megjithatë edhe më tutje mbeten disa mangësi të cilat duhet të adresohen sa i përket aktiviteteve të prokurimit dhe procedimit të pagesave.

Çështja 2 - Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas udhëzuesit operativ të prokurimit publik, neni 62.3 parimet e ndarjes së detyrave, një zyrtar i cili ka qenë anëtarë i komisionit të vlerësimit nuk mund të caktohet menaxher i projektit.

Tek procedura e prokurimit për "Furnizim me televizorë LED" për nevojat e ZPK-së, zyrtari i njëjtë ishte caktuar anëtarë i komisionit të vlerësimit dhe menaxher i kontratës, duke mos ndjekur parimet për ndarjen e detyrave.

Rreziku Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave rrit rrezikun e paraqitjes së konflikt të interesit.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e formimit të komisioneve të ndryshme do të respektohen parimet për ndarjen e detyrave me qëllim që të evitohen konfliktet e mundshme të interesit.

Çështja 3 - Dobësi në procesin e vlerësimit të tenderëve - Prioritet i lartë

E gjetura Tek aktiviteti i prokurimit "Shërbimet e autolarjes së veturave zyrtare të ZPK-së", në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë të datës 23.03.2016 ishin vendosur kërkesat për përshtatshmëri teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik si vijon: 1) Operatori Ekonomik (OE) duhet të dëshmojë që ka së paku dy punëtor të angazhuar duke sjellë si dëshmi kontratat e punëtorëve me orar të plotë dhe fleksibil edhe gjatë ditëve të pushimit. 2) Të dëshmojë që ka pajisje për autolarje dhe 3) të dëshmojë që ka hapësirë të mjaftueshme për larjen e veturave.

Megjithatë, komisioni gjatë vlerësimit të ofertave nuk kishte marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit të cekura më lartë dhe ishte shpërblyer me kontratë OE pa u vlerësuar fare oferta për përshtatshmëri teknike dhe profesionale. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë nga komisioni i vlerësimit dhe mos mbikëqyrjes adekuate nga udhëheqësi i prokurimit.

Rreziku Shpërblimi me kontratë i OE në mungesë të plotësimin të kriterëve rrit rrezikun që OE fitues të mos posedojë kapacitetin e mjaftueshëm teknik dhe profesional për kryerjen e shërbimeve për të cilat është kontraktuar dhe si pasojë mund të dështojë në kryerjen e shërbimeve.

Rekomandimi 3 Sekretari i Përgjithshëm duhet të shtojë kontrollet tek aktiviteti i prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave nga komisionet vlerësuese të bëhet në përputhje me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit, si dhe të sigurojë se aktivitetet e prokurimit mbikëqyren nga udhëheqësi i prokurimit.

Çështja 4 - Mos respektimi i procedurave për procedimin e pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura Rregulla financiare nr. 01/2013 shpenzimi i parave publike, neni 21 përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, ku hapi i parë është kërkesa për blerje. Megjithatë, tek pagesa për furnizim për zyre në vlerë 6,010€ e datës 05.08.2016, procedimi i pagesës nuk është bërë në përputhje me këtë rregullore pasi që fatura ishte e datës 24.04.2016 ndërsa kërkesa për furnizim nga njësia kërkuese ishte e datës 19.07.2016, ose afro tre (3) muaj, pas faturës.

Rreziku Mos respektimi i procedurave për procedimin e pagesave respektivisht furnizimi pa kërkesë paraprake nga njësia kërkuese, rrit rrezikun për furnizime të panevojshme dhe në këtë mënyrë dëmtohet buxheti.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të ndërmerr veprime shtesë për tu siguruar se procedimi i pagesave bëhet në përputhje të plotë me hapat e përcaktuar në rregullën financiare për shpenzimin e parasë publike.

3.1.3 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 68,985€ prej të cilave 44,850€ për entitete publike dhe 24,414€ për entitete jopublike. Gjatë vitit 2016 buxheti final ishte realizuar në tërësi.

ZPK-ja ka vendosur kontrolle funksionale në fushën e subvencioneve dhe transfereve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të ZPK-së ishin 237,438€. Prej tyre 39,316€ ishin pasuritë me vlerë mbi 1,000€, 91,379€ pasuritë nën vlerën 1,000€, si dhe 106,743€ stoqet në fund të vitit.

Regjistrat ishin mbajtur në pajtueshmëri me rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Po ashtu në fund vit ishte bërë inventarizimi i pasurisë, siç kërkohet me këtë rregullore. Kontrollat në këtë fushë janë funksionale dhe nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur me përjashtim të mangësive sa i përket evidencave për shpenzimet e automjeteve.

Çështja 5 - Mungesa e evidencave të plota për përdorimin e automjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura UA 03/2008 për menaxhimin e automjeteve zyrtare neni 11.2 kërkon që Njësia e Transportit të hartojë raport për shpenzimet mujore të të gjitha automjeteve të institucionit përkatës, duke përfshirë raportin për secilin automjet veç e veç. ZPK-ja nuk kishte përgatitur ndonjë raport sa i përket shpenzimeve të servisimit dhe larjes së automjeteve. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të derivateve kishte përgatitur raporte individuale, mirëpo shënimet nuk ishin plotësisht të sakta. Në katër (4) raste ne vërejtëm mospërputhje ndërmjet të dhënave të raportuara dhe dëshmime mbështetëse.

Rreziku Mos mbajtja e evidencave të sakta për shpenzimet e automjeteve mund të ndikojë që kostoja e shpenzimeve të jetë e lartë dhe menaxhmenti të mos ketë informata të mjaftueshme për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të tyre.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrolle efektive në menaxhimin e automjeteve për të siguruar se do të mbahen evidenca të rregullta sa i përket shpenzimeve të automjeteve siç kërkohet me udhëzimin administrativ përkatës, si dhe ekziston një raportim i plotë për menaxhmentin.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 104,124€. Obligimet e papaguara në krahasim me vitin paraprak ishin rritur për 64% (në fund të vitit 2015 ishin 67,180€). Faturat për obligimet e papaguara kryesisht i takonin muajit dhjetor 2016 të cilat nuk ishin paguar për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave.

Çështja 6 - Vonesa në pagesën e faturave /obligimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas nenit 39 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Gjatë testeve tona kemi vërejtur që në tri (3) raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë 22,511€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor.
- Rreziku** Mos pagesa e obligimeve brenda afatit kohor ligjor mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve për shkak të ndëshkimeve me kamata nga furnitorët si dhe rritjen e obligimeve të papaguara në fund të vitit.
- Rekomandimi 6** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit kohor ligjor në mënyrë që të shmanget ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari, apo rritja e obligimeve të papaguara në fund të vitit.

Çështja 7 - Mos raportimi i obligimeve të papaguara - Prioritet mesëm

- E gjetura** Sipas rregullores NR. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara, Organizatat Buxhetore janë të obliguara që në MF të raportojnë në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara. Në tri (3) raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 14,751€ nuk ishin përfshirë në raportet mujore të obligimeve.
- Rreziku** Kontrollat jo të mira në raportimin e obligimeve rrisin rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë. Njëkohësisht, ndaj ZPK-së mund të paraqiten ndëshkimet për vonesat në pagesë.
- Rekomandimi 7** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se raportimi i obligimeve të papaguara do të bëhet në përputhje me rregulloren 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Rekomandimet e vitit paraprak	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i veprimit rishikohet në vazhdimësi në mënyrë që të përcaktoj një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, një pjesë e rekomandimeve nuk janë zbatuar plotësisht.	
Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
Vlerësimi i rrezikut	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut te një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve.	Po		
Prokurimi	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se dobësitë në procesin e prokurimit janë evituar dhe se rregullat e prokurimit dhe kriteret e kërkuara në dosje të tenderit respektohen në plotësi para se të nënshkruhet kontrata. Po ashtu Sekretari duhet të sigurojë se departamenti i prokurimit analizon paraprakisht se cila nga procedurat e prokurimit do të ishte më e përshtatshme për secilin tender që planifikon ta shpallë. Për lidhjen e kontratës për çmimet për njësi duhet të shfrytëzohet kontrata kornizë.			Nuk është zbatuar

Shpenzimet jo përmes prokurimit	Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcoj nivelin e kontrollit mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë dhe reprezentacionit për të racionalizuar ato. Në rastet shumë specifike mund të ketë tejkalime dhe vetëm për ato raste duhet të bëhet aprovimi por që tejkalimet nuk duhet të bëhen dukuri. Për tejkalime të cilat nuk kanë aprovim, duhet aplikuar ndalesa nga paga.	Po		
Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të diskutojë me MAP-in dhe rishikoj mundësitë e gjetjes së një zgjidhje për sistemin e-pasuria. Instalimi i sistemit e-pasuria apo një zgjidhje që mund të gjendet në kuadër të dy institucioneve do të jetë e pranueshme.		ZPK, ka instaluar softuerin e-pasuria dhe ka filluar aplikimin e tij. Tani janë në proces të bartjes së shënimeve nga regjistri i brendshëm në e-pasuri.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT

REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT

REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

SEKRETARI I ZYRËS – SECRETARY OFFICE – SEKRETAR KANCELARIJE

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, në emër të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, konfirmoj se kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Presidentit për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");

Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment të veçantë për përmbajtjen e Raportit, megjithëse në komentet tona ju kemi njoftuar paraprakisht me masat që janë ndërmarra për të përmirësuar performancën dhe kontrollin e brendshëm në çështjet e ngritura.

Po kështu ju njoftoj se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj informatën për masat e ndërmarra dhe një plan komplet të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Fehmi Mehmeti 

Sekretar i Përgjithshëm

Data: 30.05.2017